



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW
BODY

Në bazë të nenit 102, si dhe nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, dhe nenit 11 pika 6 e Rregullores së Punës së OSHP-së, Bordi i OSHP-së, në mbledhjen e datës 17.09.2015 bënë ndryshimin dhe plotësimin e Njoftimit të dt. 19 nëntor 2014, me nr. të protokollit 848/ 14, mbi procesin e shqyrtimit të ankesave, dhe merr këtë :

V E N D I M

- I. Operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, është i obliguar të dëshmojë në ankesë se ka interes juridik- material konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111 par.1 pika 1.5 të LPP-së , në aktivitetin e prokurimit për të cilin parashtron ankesë.
- II. Operatori ekonomik ankues konform nenit 111 të LPP-së, është i obliguar që në ankesë të specifikoj dispozitat apo dispozitën e këtij ligji që supozon që është shkelur nga autoriteti kontraktues, si dhe rrethanat faktike që përbëjnë apo ngrisin supozimin për shkelje të këtij ligji. Nëse operatori ekonomik ankues nuk vepron në këtë mënyrë atëherë paneli shqyrtues do ta hudh poshtë si jo të plotë ankesën e ankuesit.
- III. Operatori ekonomik ankues është i obliguar që në ankesë të specifikoj qartë propozimi për panelin shqyrtues që aktiviteti i prokurimit për të cilin parashtron ankesë të **anulohet** apo **rivlerësohet**.
- IV. Me rastin e shqyrtimit të ankesës, eksperti shqyrtues fillimisht është i obliguar që të shqyrtoj ofertën e ankuesit se i njejtë a është i përgjegjshëm-a e ka atributin e palës së interesuar konform nenit 4.1.26 të LPP-së e pastaj të procedojë me shqyrtimin e ofertave tjera. Nëse ankuesi është i papërgjegjshëm –atëherë eksperti shqyrtues e ndërpret ekzaminimin e ofertave tjera dhe i dorëzon një raport të shkurtër panelit shqyrtues me rekomandim që ankesa e ankuesit të hudhet poshtë si e palejuar për shkak të mungesës së interesit juridik-material.

V. Eksperti shqyrtues gjatë ekzaminimit të ankesës së OE.ankues do të veprojë njëjtë sikur në pikën IV.të këtij vendimi edhe nëse ankesa e OE.ankues është e përgjegjshme , por i njëjti operator ekonomik me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim nuk do të mund të shpallej fitues i aktivitetit të prokurimit-(psh.ankuesi është i rradhitur i treti i katërti e kështu me radhë.) dhe se të njëjtit do ti mungonte interesi juridik-material konform nenit 111 par.1 pika 1.5 e LPP-së.

VI.Eksperti shqyrtues në rast se propozon që një aktivitet i prokurimit të kthehet ne rivlerësim, është i obliguar që ti dëshmoj panelit shqyrtues se në aktivitetin e prokurimit për të cilin është parashtruar ankesa, janë më shumë së dy oferta të përgjegjshme, ashtu siç kërkohet me nenin 32 paragrafi 4 të LPP-së.

VII. Lidhur me zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset bordi i OSHP-së dhe kryesuesi i sekretariatit të OSHP-së.

VIII. Ky vendim hin në fuqi nga dita e marrjes së tijë i cili njëherit inkorporohet edhe në rregulloren e punës së OSHP-së dhe i njëjti do të publikohet në web faqën e OSHP-së.

17.09.2015
Prishtinë

